



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

**Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione**

P-nr.89/2024

Prishtinë, më 14.5.2024, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203.

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albana Bytyçi, Nasuf Bejta, Drita Millaku, Fatmire Kollçaku, Labinotë Demi- Murtezi dhe Ariana Musliu- Shoshi.

Munguan: Duda Balje, Arjeta Fejza, Eliza Hoxha dhe Marigona Geci.

Stafi mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator i Komisionit dhe Sulltane Gashi, zyrtare e lartë në Komision.

Pjesëmarrës të tjerë: Milazim Govori-Policia e Kosovës, Xhemile Behluli-Policia e Kosovës, Zylfije Deama-Policia e Kosovës; Gent Ramosaj-GP AAK, Hysni Mehani-GP LVV; Liridon Salihi-GLPS, Kaltrina Ibërdemaj-GP LVV; Ardianë Halimi-NDI; Sanije Berisha-OSBE; Marigona Pajaziti-Kuvendi i Kosovës; Anita Nikaj-gazeta “Nacionale”; Shqipe Pajaziti-Kosovapress; Gëzim Mujaj-Ekonomia Online; Bjondina Çanta-Kuvendi i Kosovës, dhe Besarta Pllana-Kuvendi i Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi Albana Bytyçi, nënkryetare e dytë e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Diskutim në Komision lidhur me rastet e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore;
Të ftuar: përfaqësuesit kompetentë të Policisë së Kosovës për luftimin e dhunës në familje.
3. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23 prill 2024;
4. Shqyrtimi i peticioneve;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Diskutim në Komision lidhur me rastet e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore;

Të ftuar: përfaqësuesit kompetentë të Policisë së Kosovës për luftimin e dhunës në familje.

Kryesuesja, tha se kemi prezent në këtë takim Zylfije Dema, nënkolonele, Luljeta Limani, nënkolonele, Xhemile Behluli, rreshtere, dhe Milazim Govori, rreshter, Përfaqësuesit kompetentë të Policisë së Kosovës për luftimin e dhunës në familje, si dhe falënderoi për pjesëmarrjen në Komision. Fjalën ia kaloi znj. Zylfije Dema.

Zylfije Dema, drejtore e Divizionit të Policimit në Bashkësi, tha se ky divizion që mbulon një pjesë të madhe të fushës së parandalimit të dhunës në familje, të krimit dhe të dukurive negative që potencialisht mund të shfaqen në shoqëri, duke përfshirë edhe parandalimin dhe hetimin e dhunës në familje. Udhëheqja dhe menaxhimi i Divizionit të Policimit në Bashkësi dhe aktivitetet parandaluese janë në kuadër të tri drejtorive, Drejtoria për Parandalimin dhe Hetimin e Dhunës në Familje, Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim, si dhe Drejtoria për Ofrimin e Sigurisë së Trashëgimisë Kulturore.

Konceptet dhe parimet bazë në kuptimin e dinamikave të përfshira në forma të ndryshme të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje kanë evoluar dhe vazhdojnë të evoluojnë jo vetëm në Kosovë, por në tërë botën.

Policia e Kosovës, gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje, ka prioritet parandalimin e dhunës në familje, të ofrojë mbrojtje dhe siguri për viktimat dhe të tjerët, të zhvillojë hetim profesional për të gjitha incidentet e raportuara të abuzimit në familje, në një mënyrë të qëndrueshme, të fuqishme dhe aktive, në përputhje me standardet hetimore.

Policia e Kosovës, në kuadër të strukturës organizative, ka ngritur nivelin e strukturimit nga sektori në drejtori, që tashmë është formuar dhe e funksionalizuar. Pra, Drejtorinë për parandalim dhe hetimin e dhunës në familje, sektorë dhe njësi të veçanta me personel të trajnuar dhe të profilizuar, për t'i trajtuar rastet e dhunës në familje dhe për të ofruar mbrojtje, siguri dhe shërbimet e nevojshme për viktimat e dhunës në familje.

Ajo tha se Policia e Kosovës, dhunën në familje e trajton në tri nivele: në nivelin qendror, në nivelin rajonal dhe në nivelin lokal.

Niveli qendror, ku është Divizioni i Policimit në Bashkësi, në kuadër të së cilës është Drejtoria për Parandalimin dhe Hetimin e Dhunës në Familje, ka përgjegjësi hetimin, kontrollin, monitorimin gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje, në të gjitha nivelet e hetimeve.

Niveli rajonal funksionon në 8 drejtori rajonale të Policisë, ku janë të caktuar policë hetues, të cilët janë të trajnuar dhe të profilizuar për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe të cilët janë 24h kujdestar për të ofruar siguri, mbrojtur dhe për të ofruar shërbimet e nevojshme për viktimat e dhunës në familje.

Niveli lokal funksionon në 41 stacione policore, i cili funksionon në 38 komunat e Kosovës, ku përveç policëve reagues dhe sektorial, janë të caktuar policët hetues, të cilët janë të trajnuar dhe të profilizuar për të trajtuar rastet e dhunës në familje. Policia e Kosovës aplikon qasje në fokus, ku viktimat të jenë në qendër të të gjitha masave, duke bashkëpunuar në mënyrë efektive me të gjithë aktorët relevantë, si dhe duke konsideruar edhe parimet e sigurisë së viktimës, privatësinë, respektimin dhe mosdiskriminimin.

Policia, rastet e dhunës në familje i trajton duke u bazuar në ligjet e Republikës së Kosovës, si dhe dokumenteve dhe udhëzimet relevante, vendore dhe ndërkombëtare, dhe

për këtë arsye, Policia e Kosovës ka hartuar procedurat e punës standarde të veprimit, ku bazohet puna e zyrtarëve policorë gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje.

Policia e Kosovës, rastet e dhunës në familje i trajton në bashkëpunim të plotë me Prokurorinë e Shtetit, Gjykatat, Qendrën për Punë Sociale, mbrojtësin e viktimave, Strehimoret, institucionet shëndetësore, arsimore, si dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare, që në forma të ndryshme, ofrojnë ndihmë dhe shërbime për viktimat e dhunës në familje.

Njoftoi se momentalisht janë funksionalizuar 28 dhoma mike në stacionet policore, aty ku nuk ka dhoma mike, janë ndarë në zyra të veçanta për trajtimin e këtyre rasteve. Policia në realizimin e obligimeve ligjore që ka në lidhje me informimin e viktimave mbi të drejtat e tyre ka krijuar pako informuese për viktimat e krimit, e cilësuar si kartela e viktimës, e cila i jepet secilës viktimë që në momentin e inicimit të rastit në Policinë e Kosovës. Kjo kartelë përfshin të dhënat e përgjithshme për rastin, të dhënat kontaktuese të zyrtarit përgjegjës për rastin, pastaj obligimet e policisë në trajtim të rasteve dhe mënyrat e raportimit të rasteve në Policinë e Kosovës. Kjo kartelë, përveç pikave të lartcekura, pikë të veçantë ka edhe të drejtat e viktimave të dhunës në familje, si e drejta për mbrojtje, ndihma juridike falas, strehimi e të tjera.

Raportimi i rasteve të dhunës në familje për periudhën janar- prill 2024, numri i rasteve është 927, numri i viktimave është 989, viktima femra 770, viktima meshkuj 219, persona të ndaluar për 48 orë 341, urdhra mbrojtës të lëshuar nga gjykata 447, urdhra për mbrojtje të përkohshme emergjente të shqiptuar nga policia 51.

Tha se duhet të punohet më shumë për parandalimin dhe duhet të punojmë të gjithë së bashku me institucionet shtetërore dhe shoqëria civile.

Kryesuesja, tha se nga statistikat që u prezantuan, shihet se dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore është në rritje. Cila është arsyeja e rritjes së kësaj dhune dhe cilat janë mjetet kryesore që po i përdor Policia e Kosovës, për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar dhunën? A ka policia bashkëpunim me Gjykatën dhe Qendrën për Punë Sociale, a ka vonesa të procedimit të kallëzimit penal?

Zylfije Dema, tha se sa i përket çështjes së bashkëpunimit me gjykatat, mbrojtësit e viktimave, dhe Qendrën për Punë Sociale, bashkëpunimi është i shkëlqyeshëm, por ka një çalim për shkak se mbrojtësit e viktimave nuk shkojnë në vendin e ngjarjes në stacion asnjëherë. Punonjësi i Qendrës për Punë Sociale del në stacion, sepse asnjë rast i dhunës në familje nuk trajtohet pa qenë zyrtari i Qendrës për Punë Sociale dhe raporti i policisë çdoherë i shkon edhe Qendrës për Punë Sociale e edhe mbrojtësit të viktimës.

Kryesuesja pyeti: A kanë shpërndarë kartela të viktimës nëpër qytete të ndryshme, a është bërë fushatë vetëdijësuese për këto kartela, a lejohet të shpërndahen këto kartela për qytetarë që kanë nevojë për informim?

Zylfije Dema, tha se policia ka bërë fushata të ndryshme për ndërgjegjësim dhe vetëdijësim të qytetarëve, janë shpërndarë njoftime nga më të ndryshmet dhe janë shpërndarë numrat e telefonit, ku mund të raportojnë dhunën në stacionin më të afërm. Më aktiv ka qenë aplikacioni lajmëro policinë dhe mund të raportohen rastet e dhunës në familje në mënyrë anonime, mbahen ligjërata me nxënësit e shkollave fillore, të shkollave të mesme, ligjërohet nëpër fakultete për t'u njoftuar të gjithë qytetarët për pasojat, por në të njëjtën kohë edhe për raportim tek organet e sigurisë.

Luljeta Limani, tha se vitin e kaluar është realizuar shpërndarja e kartelave vetëdijesuese, prej 68200 në tërë Kosovën, në kuadër të aktiviteteve që janë realizuar për parandalimin e dhunës në familje.

Fatmire Kollçaku, tha se i inkurajon që të përdoren dhomat e veçanta në rastin e marrjes së dëshmime të viktimave, sepse kërkohet një ambient shumë miqësor, sepse viktimat janë të traumatizuar.

Ajo pyeti edhe për bashkëpunimin e policisë me institucionet shëndetësore, pasi që tha se policia i përcjell viktimat edhe në institucionet shëndetësore, sa përgjigjen me etiken e punës në qasjen ndaj viktimës. Dihet se ka raste kur nuk janë trajtuar në mënyrë dinjitoze dhe duhet ta keni edhe një buxhet për mbështetjen e këtyre viktimave.

Po ashtu, tha se cilat janë kërkesat konkrete të Policisë së Kosovës, që duhet të ngrihen në institucionet tjera, qoftë në aspektet buxhetore apo mbështetjen me staf, apo nevojat tjera që i keni lidhur me ushtrimin e detyrës së juaj.

Luljeta Limani, tha se në kuadër të policisë, kanë ndërmarrë veprimet të cilat kanë rritur në drejtori sektorin e dhunës në familje, po ashtu janë shtuar numrat e nënstacioneve policore dhe hetuesit primarë të dhunës në familje, në të gjitha stacionet policore janë të liruar nga detyrat tjera hetimore, përveç hetimit të rasteve të dhunës në familje. Në të gjitha stacionet policore, ku ka dhoma mike, është obligues trajtimi i viktimave në ato dhoma, në ato stacione, ku nuk ka pasur mundësi, ka dhoma të veçanta që së paku të jetë një ambient sa më miqësor dhe të jetë një trajtim sa më dinjitoz i tyre.

Me Ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje..., sa i përket buxhetit, kjo është paraparë te Qendra për Punë Sociale dhe ende janë duke pritur, janë formuar grupet punuese në nivele qeveritare dhe besohet se kjo gjë do të shtjellohet dhe do të zgjidhet. Pra, është e vërtetë se derisa të ketë një zgjidhje, policët me mjete vetanake, blejnë gjëra të nevojshme për viktimat, për shkak se shpesh fëmijët janë në pyetje, dhe kjo është solidaritet.

Sa i përket bashkëpunimit me institucionet tjera, tha se te trajtimi i rasteve të dhunës në familje, është obligim të njoftohet Qendra për Punë Sociale dhe mbrojtësin e viktimave. Lidhur me prokurorinë dhe gjykatën, tha se prokurori është ai që i udhëheq hetimet dhe përgjigjen në secilin rast, ndërsa në gjykatë shkon rasti dhe është jashtë domenit të policisë.

Labinotë Demi- Murtezi, tha se është mirë që në të ardhmen, të ketë më shumë patrullime dhe lëvizje të policisë në të gjitha vendbanimet, sidomos në qytete dhe prokuroria dhe gjykatat duhet të jenë më duar shtrënguar. Pyeti: A ekzistojnë hallkat që u vendosen kryerësve të dhunës në familje që t'i përcjellë policia, se ku gjinden, si kryerësi si viktimat? Sepse, ndikon në parandalimin e dhunës.

Zylfije Dema, tha se në 8 drejtoritë rajonale veprojnë sektorët si përfaqësues të lagjeve, të cilët bashkëpunojnë me përfaqësuesit e lagjeve, në bazë të Ligjit të policisë. Drejtori i policisë ka të drejtë të mbajë forumet e sigurisë publike, që si polici bashkëpunojnë dhe mbajnë shumë aktivitete vetëdijesuese për parandalimin e shumë llojeve të krimeve, duke përfshirë edhe parandalimin e drogave. Çështja e parandalimit është sfiduese për të gjitha institucionet e edhe për vet shtetin.

Milazim Govori, tha se procedimi i rasteve prej policisë, në fazën e hetimit të rasteve të dhunës në familje, kur ka persona të ndaluar për 48 orë, pastaj shkojnë me urgjencë, ndërsa të gjitha rastet që mbesin në hetim dhe janë në procedurë të rregullt, shkojnë në prokurori në kohë optimale dhe asnjë rast nuk mbetet brenda javës në hetim.

Ai shtoi se bashkëpunimit me institucionet tjera, si ato shëndetësore, ato të arsimit, është shumë i mirë.

Ariana Musliu- Shoshi, pyeti: Si është bashkëpunimi i Drejtorisë për Parandalimin nga Mbrojtje e Dhunës në Familje në nivelin qendror, me atë të niveleve lokale apo rajonale? Sa është numri i personave të angazhuar në këtë drejtori në nivelin qendror? 28 dhomat mike, a janë në nivel qendror apo në nivel rajonal? Sa u përket hallkave elektronike, e dimë se është ndarë buxhet nga Kuvendi i Kosovës dhe nuk dihet pse nuk po implementohet deri më tani. Procesi është dashur të përshpejtohet, duke marrë parasysh numrin e rritjes së rasteve të dhunës në familje, konkretisht ndaj grave.

Cilat janë sfidat që ka policia në zbatim të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, dhe cila është detyra kryesore e taks forcës për parandalimin e dhunës në familje dhe kush janë anëtarët e saj?

Luljeta Limani, tha se si drejtori qendrore, kanë raporte shumë të mira me të gjitha rajonet. Drejtoria për Parandalimin, Hetimin e Dhunës në Familje i ka në total 21 staf të paraparë në strukturë, kurse sa i përket personelit në stacione dhe rajone, janë 117 staf, që janë të emëruar vetëm për dhunë në familje, duke i përfshirë të gjitha stacionet dhe drejtoritë rajonale. Dhomat mike janë të shpërndara nëpër disa stacione dhe rajone, aty ku ka pasur mundësi teknike janë realizuar dhe po bëhet përpjekja, aty ku mungojnë për t'u ngritur këto dhoma, sepse ligji i obligon për këtë.

Sa i përket taks forcës, tha se nuk kanë taks forcë, për shkak se tani është drejtoria në nivel qendror, që i ka detyrat e përcaktuara në strukturë, të gjitha stacionet i kanë zyrtarët përkatës.

Ariana Musliu- Shoshi, tha se ka qenë kërkesë e Ministrisë së Drejtësisë, që të krijohet një task forcë dhe prandaj ishte e interesuar të dinte se ku ndodhej procesi lidhur me të.

Luljeta Limani, tha se koordinatori Nacional për Mbrojtje nga Dhuna në Familje i ka grupet ndërministrorë që mbledhen, por nuk është taks forcë.

Drita Millaku, tha se çdo ditë dëgjojnë raste nga më të ndryshmet, edhe pse në legjislacion janë bërë shumë ndryshime pozitive, duke bërë ligje më të rrepta, duke menduar se do të ketë ndikim në ndaljen e kësaj dukurie. Ajo pyeti: Çka duhet bërë, si Parlament, që të bashkëpunojmë dhe të ndihmojmë në uljen e rasteve të dhunës në familje? Cili është shkaktari kryesor që vjen deri te dhuna në familje?

Zylfije Dema, tha se kanë raportin analitik të vitit 2023, dhe ndër shkaqet që shkaktojnë dhunën, janë traditat e vjetra, tentimi i vënies së pushtetit ndaj njërit prej bashkëshortëve, xhelozia, kushtet sociale, marrëdhëniet e çrregullta brenda familjes, ndikimi i alkoolit dhe drogës, ndikimi i çrregullimeve mendore, ndikimi i stresit, traumat e ndryshme dhe shkaktarë të tjerë që nuk kanë mundur të përcaktohen.

Ajo tha se faktori më i shpeshtë që sjell deri te dhuna janë marrëdhëniet e çrregullta brenda familjes.

Nasuf Bejta, tha se fjala dhunë, përbehet prej shumë pak germave, por shumë probleme po sjell në shoqërinë tonë dhe nuk po dihet se çka e ka sjellë këtë situatë, niveli i tillë i demokracisë, ligjet e buta apo nuk po luftohet sa duhet ky fenomen. Në vijim, tha se e ka një brengë që dhuna nuk po shkaktohet vetëm nga ata që nuk dinë kuptimin e fjalës dhunë, por ka edhe personalitete me rëndësi që po shkaktojnë dhunë.

Ndër të tjera, tha se droga dhe dukuritë negative, po vijnë duke u rritur dhe policia kaq e përsosur nuk po mundet t'i i zbulojë të gjitha rastet. Kush e ka atë të drejtë në institucione dhe qoftë në krye të shtetit ta dëmtojë rininë dhe popullin, me këto mjete narkotike, kur kjo nuk po mund të luftohet sa duhet, ndërsa po flitet se edhe nëpër shkolla fillore po ka përdorim të këtyre substancave narkotike. Në këtë drejtim, kërkon nga policia që të mos ketë lëshime për askënd dhe të bëhet diçka për të mirën e rinisë, sepse edhe perspektiva po humbet.

Kryesuesja falënderoi përfaqësuesit nga Policia e Kosovës për prezencën dhe informacionet që paraqitën në Komision, duke shpresuar që rastet e dhunës në familje, gjithmonë të jenë në trendin e zvogëlimit.

3. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23 prill 2024

Albana Bytyçi, konstatoi se Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 23 prill 2024.

4. Shqyrtimi i peticioneve

Kryesuesja, tha se kanë një kërkesë nga Arnisa Osmani, drejtoreshë ekzekutive nga Shoqata "Have Hope Kosova", e cila merret me trajtimin dhe të drejtat e grave të mbijetuara të kancerit të gjirit.

Kërkesa në fjalë ka të bëjë me mundësinë e ndryshimit të Ligjit të punës dhe përkrahjen e pacientëve me kancer në përgjithësi.

Kryesuesja konstatoi se meqenëse kërkesa është bërë në emër të shoqatës dhe bëhet fjalë për shkaqe shëndetësore dhe humanitare, t'i rekomandohet palës, nëse ka mundësi, të grumbullohen disa nënshkrime, që të plotësohet kushti formal sipas Rregullores së Kuvendit të Kosovës dhe mund t'i drejtohen përsëri Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, në mënyrë që të shqyrtohet kërkesa.

4. Të ndryshme

Nuk pati çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:05.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Duda BALJE,
Kryetare e Komisionit